

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i përgjithshëm – Divizioni Penal, me Gjyqtarin e vetëm gjykues Rustem Begolli, me zyrtaren ligjore Sanije Torshupa, duke vendosur në çështjen penale kundër të akuzuares V. M. nga P., për shkak të veprës penale Ndryshimi i njehsorit të shërbimeve nga neni 323 par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm P.II.nr.7820/2013, dt.03/12/2013, të cilën e përfaqëson Prokurori i Shtetit Rukije Sheshivari, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 19/06/2017, në prezencën e Prokurorit të Shtetit, dhe të akuzuares, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, aktgjykimin, data e përpilimit të aktgjykimit **19/06/2017**:

A K T G J Y K I M

E akuzuara **V. M.**, nga i ati H., e ëma N., e gjinisë H., e lindur me datën *data e lindjes...*, në P., ku edhe tani jeton në lagjen V., rruga “H. G.”, nr./..., me numër personal *numri persoal...*, e gjendjes së varfër ekonomike, e martuar, ka të kryer fakultetin e arteve, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Prej datës së pavërtetuar e deri me datën 23/08/2013, në shtëpinë e saj që gjendet në P., rruga “...”, p/n, e pandehura V. M., për plotësimin e nevojave të veta me energji elektrike, ka penguar njehsorin elektrik, në atë mënyrë që ka shpuar dhe thyer kapakun nga ane e epërme e njehsorit (ka një vrimë), ku përmes së cilës është penguar puna e diskut dhe disku i njehsorit është gërvishur, me qëllim të shmangies së pagesës së energjisë së shpenzuar elektrike, me ç ‘rast të dëmtuarës KEDS – Distrikti në Prishtinë, i ka shkaktuar dëm në shumën prej 162,93 euro.

- **Më këtë ka kryer veprën penale Ndryshimi i njehsorit të shërbimeve nga neni 323 par.1 të KPRK-sës.**

Andaj gjykata në kuptim të neneve 4, 41, 42, 46, 49, 50, 51, 52 dhe 73 të KPRK-së, si dhe në bazë të nenit 365 KPPRK-së, të akuzuares i:

S H Q I P T O N

Dënimin me kusht, duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet po që se e akuzuara në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti, nuk do të kryej vepër tjetër penale, si dhe **dënimin me gjobë në shumë prej 200.00 € (dyqindë euro)**, të cilin dënim e akuzuari është e obliguar që ta paguaj në afatin prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi në të kundërtën dënimi me gjobë do të shndërrohet në dënim me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) dite, duke i llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg shumën prej 20 (njëzetë) euro.

Obligohet e akuzuara që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, kurse në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 (njëzetë) €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar KEDS – Distrikti në Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontestin e rregullt civilo juridik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën P.II.nr.7820/2013, dt.03/12/2013, e ka akuzuar të akuzuaren V. M., për shkak të veprës penale Ndryshimi i njehsorit të shërbimeve nga neni 323 par.1 të KPRK-së.

Gjykata lidhur me këtë rast, ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datën 19/06/2017 dhe në këtë seancë e akuzuara është njoftuar me të drejtat e saj në këtë çështje penale, ku pas leximit të aktakuzës, e akuzuara ka deklaruar se e ka kuptuar akuzën dhe nuk ka nevoj për ndonjë sqarim.

E akuzuara V. M., në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se ndjej vetën fajtor për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe e pranoj fajësinë për çdo pikë të aktakuzës.

Pas pranimit të fajësisë gjykata ia ka tërhequr vërejtjen të akuzuares, lidhur me pasojat e pranimit të fajësisë, dhe atë dënimin e kësaj vepre penale që e parasheh ligji për Ndryshimi i njehsorit të shërbimeve nga neni 323 par.1 të KPRK-së, dënim me gjobë dhe dënimin me burgim deri në tre (3) vite, se nuk do të mund ti kundërshtoj provat apo të parashtrij prova në këtë çështje penale, se nuk do mund ta atakoj vendimin e gjykatës lidhur me vërtetimin jo të plotë apo të gabuar të gjendjes faktike, por se mund ta atakojnë për shkak të lartësisë mbi dënimin dhe se deklarimi mbi pranimin e fajësisë gjykata detyrimisht duhet ta vlerësoj si rrethanë lehtësuese.

Prokurori i Shtetit, lidhur me deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuares, deklaroi se pajtona me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuares, ashtu që mbetem në tërësi pran aktit akuzues, pasi që e akuzuara e ka pranuar fajësinë dhe një pranim i tillë është bërë konform dispozitave ligjore dhe në përputhshëmri me provat të cilat iu janë bashkangjitur aktakuzës.

Gjyqtari i vetëm gjykues bindet se e akuzuara e kupton natyrën dhe pasojat e fajësisë, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga e akuzuara, pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit.

Gjykata pranimin e fajësisë nga e akuzuara e ka pranuar duke u bindur se e njëjta i ka kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë, kurse ky pranim i fajësisë është mbështetur edhe në provat tjera, të cilat gjenden në shkresat e lëndës e që e vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprës penale, e ku krijohet figura në tërësi e veprës penale të cilën e ka kryer e akuzuara, andaj, gjykata mbi këtë bazë ka vlerësuar

këto prova dhe deklarin e pranimit të fajësisë nga e akuzuara e ka vlerësuar dhe e ka pranuar.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat të cilat konform nenit 73 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethanë lehtësuese për të akuzuaren, gjeti se e akuzuara e ka pranuar fajësinë, se ka patur sjellje të mirë gjatë seancës, se ka premtuar se në të ardhmen nuk do të bie ndesh me ligjin, se është hera e parë që bie në kundërshtim me ligjin, ndërsa rrethana posaçërisht rënduese nuk gjeti, andaj, gjykata të akuzuares i shqiptoj dënimin sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata çmon se dënimi i shqiptuar është i drejt dhe i ligjshëm, se është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuares dhe me intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur. Duke gjetur se ky dënim është dënim adekuat me shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuares dhe se në këtë dënim ndaj saj, do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në kuptim të nenit 450 par.2 të KPPRK-së.

Vendimin për kërkesën pasurore juridike, gjykata e ka marrë në kuptim të nenit 463 par.2 të KPPRK-së.

Nga theksimet e theksuara si me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.4068/2013 dt.19/06/2017

Zyrtarja ligjore
Sanije Troshupa

Gjyqtari i vetëm gjykues
Rrustem Begolli

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.